

VENDIM
Nr. 128, datë 29.7.2016

**MBI TARIFAT E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË TM DHE ME MATËS NË TU, PËR PERIUDHËN
1 KORRIK–31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve, 16; 20, germa “c” dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, vendimit nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal” dhe nenit 22 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 10657 prot., datë 20.5.2016, aplikoi për tarifa për një kategori të re konsumatorësh, e cila nuk ka qenë e përfshirë në strukturën ekzistuese të tarifave, konkretisht për konsumatorët e lidhur në TM, por me matje në TU.

- OSHEE deklaroi se një pjesë e klientëve kanë kontrata të pikëlidhjes në TM, por matës të energjisë, në pjesën pas pajisjeve transformuese dhe transmetuese, të cilat janë në pronësi të tyre.

- ERE, me shkresën nr. 508 prot., datë 14.7.2015, ka adresuar tek OSHEE sh.a. zgjidhjen për këtë problematikë, duke kërkuar që në lidhje me grupin e konsumatorëve për të cilët nuk ka mundësi të zhvendoset pika e matjes (për shkak se janë të lidhur në kabina nga të cilat furnizohen edhe klientë të tjerë, kanë konsum të ulët dhe nuk plotësojnë kushtet teknike), të vazhdohet faturimi me çmimin e TU-së.

- Niveli i humbjeve teknike për vitin 2016 parashikohet të jetë më i ulët se viti paraardhës.

- Në zbatim të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe të furnizimit me energji elektrike”, OSHEE ka detyrimin të blejë energji nga burimet e rinovueshme të energjisë për mbulimin e humbjeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, të miratojë tarifën 12.4 lekë/kwh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik) për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016 nga furnizuesi universal.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. për vendim-marrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti